

V E N D I M
Nr.99, datë 21.2.1995

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.310, DATË 24.7.1992 “PËR KOMPENSIMIN PËR FRYMË TË SHPENZIMEVE NGA RRITJA E ÇMIMEVE TË DISA ARTIKUJVE USHQIMORË” DHE NR.274, DATË 12.6.1993 “PËR KOMPENSIMIN PËR FRYMË TË SHPENZIMEVE NGA RRITJA E ÇMIMIT TË BUKËS”

Me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme, Shërbimit Informativ Kombëtar dhe të Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.310, datë 24.7.1992, shkronja “e” e pikës 1 në kapitullin I shfuqizohet, kurse përmbajtja e shkronjës “a” në pikën 2 të këtij kapitulli ndryshohet si vijon:

“Personave që janë efektivisht në ngarkim të të punësuarve në sektorin buxhetor shtetëror, të ushtarakëve të shërbimit aktiv të përhershëm, të ushtarakëve në lirim që trajtohen me shpërblim sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.225, datë 29.5.1992, dhe të personave të tjerë që përmenden në pikën 1 të këtij kapitulli”.

2. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.274, datë 12.6.1993, pika 6 në kapitullin I të tij shfuqizohet, kurse përmbajtja e pikës 7 në po këtë kapitull ndryshohet si vijon:

“Personave që efektivisht janë në ngarkim të të punësuarve në sektorin buxhetor shtetëror, të ushtarakëve të shërbimit aktiv të përhershëm, të ushtarakëve në lirim që trajtohen me shpërblim sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.225, datë 29.5.1992, dhe të personave të tjerë që përmenden në pikat e mësipërme”.

3. Masa e kompensimit mujor për vete prej 494 lekësh, që përfitojnë ushtarakët e dalë në lirim para datës 16.1.1994 nga zbatimi i reformës në strukturat e Forcave të Armatosura, i bashkohet shpërblimit që ata përfitojnë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.225, datë 29.5.1992.

Nuk përfitojnë kompensim për vete ushtarakët që kanë dalë në lirim pas datës 16.1.1994 nga zbatimi i reformës në strukturat e Forcave të Armatosura, shpërblimi i të cilëve është llogaritur mbi pagën bazë të miratuar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.617, datë 31.2.1994.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e zbatimit nga data 1.2.1995

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi